



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Turizmi i qëndrueshëm (120 SETK)**

| | |
|-------------------|-----------------------------|
| Fakulteti | Biznesi dhe Ekonomia |
| Cikli i studimeve | Cikli i dytë (Pasdiplomike) |
| SETK | 120 |

Përshkrimi i programit

Fakulteti, duke pasur parasysh interesin e studentëve dhe përvojat e fakultetit, ka zhvilluar një program studimi me objektivat e mëposhtme: studenti të përfitojë njohuri të përgjithshme dhe të kuptojë lëndët në fushën e turizmit, sidomos konceptin dhe përmbajtjen e turizmit të qëndrueshëm, si dhe përgatitjen e nxënësve për të planifikuar një turizëm të qëndrueshëm, të jenë në gjendje të kuptojnë mjedisin dhe qëndrueshmërinë e turizmit, si dhe menaxhimin e klientëve në turizëm. Programi *turizmi i qëndrueshëm* ka një qëllim parësor të pajisë studentët me njohuritë e turizmit në funksion të rritjes së vetëdijësisë për mjedisin dhe realizimin e turizmit të qëndrueshëm. Programi u ofron studentëve njohuri të gjerë në fushën e biznesit dhe turizmit dhe ofron një ndikim në shoqërinë globale.

Karriera

Pas diplomimit studentët do të jenë në gjendje:

- Të njohin, të përcaktojnë dhe të dallojnë prioritetet dhe çështjet e ndryshme në fushën e turizmit dhe të biznesit sipas rëndësisë së tyre, të zbulojnë nevojat dhe asetet e shoqërisë,
- Të posedojnë aftësi ndërpersonale, gjuhësore, analitike, organizative dhe komunikuese,
- Të identifikojnë zgjidhjet e mundshme alternative për probleme të veçanta dhe të bëjnë një zgjedhje të bazuar në metoda dhe procedura që kanë të bëjnë me ta,
- Të jenë të përfshirë aktivisht në stërvitjen e politikave sektoriale dhe mikro-ekonomike rajonale,
- Të angazhohen në punë individuale dhe grupe në kërkim për një turizëm të qëndrueshëm,
- Të mbledhin informacione në lidhje me çdo aspekt të sektorit dhe kështu të kontribuojnë në përpjekjet shkencore për një kuptim më të mirë rreth fenomeneve që ndodhin në këtë sektor në nivel vendor, mikro apo makro-rajonale,
- Të jenë në gjendje të përmirësojnë cilësinë e menaxhimit të ndërmarrjeve turistike në vend;
- Të kenë përgatitje të studimeve të fizibilitetit për investime në këtë rajon dhe për të vlerësuar mundësitë e tregut për investime që dalin nga ky sektor;
- Të kenë përgatitje të llojeve të ndryshme të festave, turneve individuale, etj.
- Të jenë të përgatitur për zhvillimin e rrjetit të integruar të relacioneve ndërmjet ofruesve të shërbimeve dhe të klientëve.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Demonstrjnë njohuri dhe të kuptuarit e lëndëve nga fusha e turizmit dhe qëndrueshmërinë e tij;
- Demonstrjnë njohuri dhe të kuptuarit e çështjeve të turizmit, si: zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit, ndikimet mjedisore të turizmit, parimet e turizmit të qëndrueshëm, eko-turizmi dhe turizmi i qëndrueshëm, studimet e rasteve për praktikën e turizmit të qëndrueshëm, etj

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Aplikimi i njohurive të tyre dhe të kuptuarit e industriaë së turizmit duke zgjidhur problemin në mjedise turistike të reja ose të panjohura;
- Huluntimi i tregut të turizmit duke i analizuar nevojat e tyre dhe menaxhimin e planeve turistike, marrëdhëniet, destinacionet, çmimet, aktivitetet promovuese, si dhe shitjet;
- Punësimi në industrinë turistike si dhe sektorët privatë që veprojnë në tregun turistik;

Aftësitë për të vlerësuar

- Vlerësimi implikimeve të marketingut për turizmin e qëndrueshëm si dizajnimi i shërbimeve, strategjitë të çmimeve, i mediave, pastaj promovimi efektiv dhe kënaqësia e konsumatorëve në një mënyrë sistematike dhe kreative;
- Vlerësimi i kushteve në mënyrë që të planifikojnë prodhimet ose shërbimet, për të koordinuar aktivitetet e marketingut në kuadër të kompanisë turistike si dhe kontrollimin dhe monitorimin e këtyre aktiviteteve të vazhdueshme në kuadër të kompanisë;
- Të menduarit në mënyrë kritike mbi çështjet e marketingut (produkti, çmimi, promovimi, njerëzit) si dhe situata e biznesit në mjediset e turizmit.

Aftësitë e komunikimit

- Drejtimi dhe inicimi i aktiviteteve strategjike si dhe planet turistike;
- Zgjidhja e mjeteve të duhura të komunikimit, për produktin, promovimin dhe shitjen e produkteve / shërbimeve;
- Shpërndarja dhe transferimi i njohurive të brezave të rinj në fushën e turizmit të qëndrueshëm.

Aftësitë e të mësuarit

- Identifikimi i nevojës personale, dhe zgjidhja e burimeve të duhura për të mësuar njohuri të mëtejshme dhe veprimi i pavarur;
- Fitimi i njohurive dhe shkathtësive të reja autonome;
- Kryerja e nismave të pavarura duke studiuar nevojat e tregut në mënyrë që të përmbushin nevojat e konsumatorëve dhe dëshirat.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [6.0 SETK] **Metodologjia e huluntimit**
- [6.0 SETK] **Kontabiliteti financiar për turizëm**
- [6.0 SETK] **Politikat zhvillimore të turizmit**

- [12.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë 1**

Semestri 2

- [6.0 SETK] **Marketingu i destinacioneve turistike**
- [6.0 SETK] **Menaxhimi i burimeve njerëzore**
- [9.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 2/1**
- [9.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 2/2**

Semestri 3

- [6.0 SETK] **Strategjitë e marketingut për zhvillimin e turizmit**
- [6.0 SETK] **Menaxhimi i kapaciteteteve turistike në R. të Maqedonisë**
- [9.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 3/1**
- [9.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 3/2**

Semestri 4

- [30.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Metodologjia e hulumtimit**

Qëllimi kryesor i këtij kursi është që të zhvillojë metoda hulumtuese dhe teknika që përdoren në studimet e turizmit. Ky kurs do t'i ndihmojë nxënësit që të përmirësojnë aftësitë e tyre analitike dhe përdorimin e metodave kërkimore të ndryshme në fushën e turizmit. Fokusi do të jetë në çështjet e aplikimit të metodave hulumtuese, që komuniteti i biznesit përballet në fushën e turizmit si në tregun e brendshëm ashtu edhe në tregun global. Gjithashtu, ky kurs do të shqyrtojë rolin e metodave kërkimore, justifikimin si dhe aplikimin e tyre në fushën e turizmit. Kjo lëndë do të mundësojë studentët të përdorin teknika të ndryshme analitike dhe metoda për hulumtimin e tyre lidhur me çështje që kanë të bëjnë me turizmin.

- **Kontabiliteti financiar për turizëm**

Qëllimi i studimit të kësaj lënde është që t'i ndihmojë studentët për të kuptuar thelbin e kontabilitetit. Lënda kontabiliteti financiar lidhet me bazat e kontabilitetit financiar. Kjo lëndë u prezanton studentëve fushën e kontabilitetit financiar dhe mbulon fushat e mëposhtme: kontabilitetin e përgjithshëm, pasqyrat financiare - bilancin e gjendjes dhe të suksesit, raportet financiare të të ardhurave, ecurinë e parave si dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital të pronësisë, të aktiveve dhe detyrimeve e kështu me radhë.

- **Politikat zhvillimore të turizmit**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që të zhvillojë idetë themelore në lidhje me politikat dhe planifikimin e zhvillimit të turizmit. Kjo lëndë do t'i ndihmojë studentët për të përmirësuar aftësitë e tyre analitike dhe përdorimin e strategjive të ndryshme për zhvillimin e politikave të turizmit. Fokusi do të jetë në çështjet e politikave për zhvillimin e turizmit, me të cilat përballet komuniteti i biznesit në fushën e turizmit si në tregun e brendshëm ashtu edhe në tregun global. Gjithashtu, kjo lëndë do të shqyrtojë politikat e ndryshme, planifikimin dhe strategjitë si dhe zbatimin e tyre në zhvillimin e turizmit. Kjo lëndë do t'u mundësojë nxënësve të jenë të vetëdijshëm për zhvillimin e politikave aktuale dhe të ardhshme si dhe planifikimin e turizmit në çdo fushë.

- **Marketingu i destinacioneve turistike**

Qëllimi i këtij kursi është që t'i njohë studentët me konceptin e marketingut të destinacioneve turistike, me specifikat e marketingut si dhe me menaxhimin e shërbimeve turistike, me marketingun e brendshëm, të jashtëm, të integruar si pjesë përbërëse e marketingut të integruar në shërbimet në turizëm, pastaj me kuptimin dhe qasjet e ndryshme për monitorimin e kënaqësisë së përdoruesve të shërbimeve dhe cilësisë së shërbimit dhe, përfundimisht edhe me rolin dhe rëndësinë e teknologjisë së re (internetit) në komunikim, në dizajnim, në ofertë si dhe me komunikimin në shërbimet turistike.

- **Menaxhimi i burimeve njerëzore**

Qëllimi i lëndës menaxhimi me burimet njerëzore është për t'i njohur studentët me rëndësinë dhe rolin e menaxhimit të burimeve njerëzore në organizatat e bizneseve bashkëkohore. Në kuadër të kësaj lënde studentët do të njihen me procesin e burimeve njerëzore si në teorinë gjithashtu edhe në praktikën e kompanive ndërkombëtare dhe vendore.

- **Strategjitë e marketingut për zhvillimin e turizmit**

Strategjitë e marketingut për zhvillimin e turizmit do të përgatisin studentët që të përdorin dhe të menaxhojnë 4P-të në turizëm, në mënyrë që të jenë në gjendje për të hartuar elemente optimale të marketingut, etj., si produktet, çmimet, promovimin dhe metodat e shpërndarjes me të cilat kompanitë përballen. Zgjidhjet në Marketing përfshijnë analiza të kujdesshme të situatës, përdorimin inteligjent të kërkimit, si dhe parimet e marketingut. Qëllimi i kësaj lënde është që të kuptohet kompleksiteti i vendimeve në strategjitë e marketingut për zhvillimin e turizmit, si dhe kornizat për analizën e tregjeve, konsumatorët, konkurrentët si dhe konceptet integruese me planin origjinal të marketingut.

- **Menaxhimi i kapaciteteteve turistike në R. të Maqedonisë**

Lënda menaxhimi i objekteve turistike në Republikën e Maqedonisë ka për qëllim të përgatisë studentët me njohuri specifike në lidhje me menaxhimin e objekteve turistike, me theks të veçantë për administrimin e objekteve turistike në Republikën e Maqedonisë. Duke marrë parasysh natyrën e lëndës, ajo do të jetë krejtësisht praktike dhe vëmendje e veçantë do t'u jepet situatave praktike me të cilat ballafaqohen organizatat e biznesit në fushën e turizmit në Maqedoni.

- **Punimi i magjistraturës**

Pas dhënies së provimeve, studenti mund të fillojë me procedurën e paraqitjes, punimit dhe mbrojtjes publike të temës së magjistraturës. Studenti zgjedh mentorin, me udhëzimin e të cilit e përgatit aplikimin e tezës së magjistraturës. Aplikimi patjetër duhet të lejohet nga Këshilli-Mësimoro Shkencor i Fakulteti. Pas punimit të versionit final të tezës së magjistraturës, Këshilli Mësimoro-Shkencor formon komision tre anëtarësh, i cili përgatit raport, me të cilin pranohet ose refuzohet teza e magjistraturës. Raporti pozitiv miratohet nga Këshilli Mësimoro-Shkencor dhe caktohet dita e mbrojtjes publike. Pas kryerjes me sukses të mbrojtjes studenti pajiset me diplomë – Magjistër i shkencave ekonomike / Drejtimi: Turizëm.

Lëndë zgjedhore

- **Menaxhimi i kualitetit në turizëm dhe në industrinë e hotelierisë**

Objektivi kryesor i kësaj lënde është të menaxhojë në mënyrën më të mirë cilësinë e shërbimit, cilësinë e shërbimeve në turizëm në përgjithësi dhe në veçanti në industrinë e hotelierisë. Më poshtë janë çështjet kryesore që lidhen me objektivat e kursit: ofrimi i shërbimeve cilësore për klientët, kuptimi dhe rëndësia e cilësisë, vlera e konsumatorit dhe cilësia e shërbimit, menaxhimi i procesit të cilësisë, ndikimi i në organizatat dhe rëndësia e cilësisë së shërbimit për turizmin dhe konceptet e mikpritjes së bashku me mekanizmin e qasjes së menaxhimit të cilësisë për të siguruar përsosmëri në shërbime përmes disa përparimeve në menaxhimin e cilësisë totale.

- **E drejta biznesore**

Qëllimi i këtij planprogrami është që studentët të fitojnë njohuri bazë të marrëveshjeve të biznesit. Në këtë mënyrë studentët njohohen me subjektet e ndryshme të biznesit, mënyrat e organizimit të subjekteve afariste, kushtet për krijimin dhe regjistrimin e subjekteve të biznesit, si pronar i vetëm, si dhe mënyrat e mbylljes së subjekteve të biznesit, metodat e krijimit të një biznesi dhe kushtet ligjore, kushtet për ndodhjen e këtyre marrëdhënieve, efektet dhe pasojat, llojet e marrëveshjeve të bizneseve, mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nga kontratat biznesore, etj.

- **Turizmi rural në Republikën e Maqedonisë**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që të zhvillojë kuptime menaxheriale të turizmit rural në Maqedoni. Kjo lëndë do t'i ndihmojë nxënësit që të përmirësojnë aftësitë e tyre analitike, vendimmarrjen si dhe zbatimin e tyre në hartimin e turizmit rural në Maqedoni. Fokusi do të jetë në turizmin rural në Republikë, te çështjet me të cilat përballen kompanitë që veprojnë në shumë pjesë të vendit. Më saktësisht kjo lëndë do të shqyrtojë rolin e turizmit rural në Maqedoni dhe do të shqyrtojë justifikimin e kësaj teorie, të sigurojë një pasqyrë të biznesit në kontekstin e Maqedonisë, si probleme dhe mundësi, sfidat, si dhe kushtet politike, kulturore, ligjore dhe ekonomike në Maqedoni, etj. Gjithashtu kjo lëndë do t'u mundësojë studentëve të aftësohen të menaxhojnë turizmin rural.

- **Eko Turizmi në Republikën e Maqedonisë**

Objektivi kryesor i kësaj lënde është që t'i zhvillojë njohuritë për mundësitë e eko-turizmit, si pjesa më e rëndësishme e eko-turizmit. Parimet e konceptit për një zhvillim të qëndrueshëm janë të përfaqësuara në pothuajse të gjitha fushat dhe sferat ekonomike, sociale, ligjore dhe të tjera. Në kuadër të kësaj lënde studentët do të fitojnë aftësitë analitike për të studiuar potencialet e turizmit gjë që është në përputhje me konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e përmirësimin e mjedisit. Në kuadër të programit do të studiohet edhe sistemi krahasimor të eko-turizmit në vendet evropiane dhe në rajon.

- **Turizmi dhe relacionet ndërkulturore**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që të zhvillojë kuptime të menaxhimit të turizmit dhe të marrëdhënieve ndërkulturore. Kjo lëndë do të ndihmojë studentet të përmirësojnë aftësitë e tyre analitike, vendimmarrjen si dhe zbatimin e tyre në hartimin e turizmit dhe marrëdhënieve ndërkulturore. Fokusi do të jetë në turizëm dhe marrëdhëniet menaxheriale ndërkulturore, çështje me të cilat ballafaqohen kompanitë që veprojnë në shumë pjesë të botës. Konkretisht, kjo lëndë do të shqyrtojë rolin e turizmit në tregjet botërore dhe do të shqyrtojë justifikimin teorik të tyre, do të japë një pasqyrë të biznesit në kontekst ndërkombëtar, si të problemeve dhe mundësive, të sfidave si dhe të kushteve politike, kulturore, ligjore dhe ekonomike në Maqedoni, etj. Gjithashtu ky kurs do t'u mundësojë studentëve të tregojnë se si të menaxhojnë turizmin dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

- **Menaxhimi i klienteve në turizëm**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që të zhvillojë kuptime menaxheriale të shërbimit të klientit në turizëm. Kjo lëndë do t'i ndihmojë studentët që të përmirësojnë të kuptuarit e tyre në strategjitë e menaxhimit në turizëm për të përmirësuar cilësinë e shërbimit, do të thotë përmbushjen e pritjeve të turistëve dhe konsumatorëve të tjerë. Qëllimi i këtij kursi është që të prezantojë, të diskutojë dhe të analizoj disa tema të rëndësishme që lidhen me organizatat e turizmit. Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lënde, studentët do të fitojnë njohuri të sfidave të përfshira në menaxhimin e klientëve në turizëm.

- **Inovacionet në turizëm**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i ndihmojë studentët për të kuptuar natyrën dhe rolin e risive në sektorin e turizmit, si një komponent i rëndësishëm i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik. Në këtë kuadër do të tregohen karakteristikat themelore të inovacioneve, proceset e risive, parimet dhe rregullat që duhet të merren parasysh në procesin e inovacionit në sektorin e turizmit dhe të konkurrencës si dhe inovacionit në turizëm. Pastaj, vëmendje do t'i kushtohet zhvillimit të strategjive për risi në institucionet hotelierike dhe agjencitë turistike, zbatimin të tyre dhe mënyrave të financimit, me qëllim përfundimtar në ofrimin e produkteve më cilësore dhe të shërbimeve të klientëve, dmth. të turistëve. Pastaj do të trajtohen edhe institucionet qeveritare dhe joqeveritare që kanë nevojë për të mbështetur risitë në fushën e turizmit si dhe mbrojtjen e tyre.

- **Marketingu i shërbimeve**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që të zhvillojë një kuptim të shërbimeve të menaxhimit të marketingut. Ky kurs do t'i ndihmojë nxënësit për të përmirësuar të kuptuarit e tyre në hartimin e strategjive të marketingut për të përmirësuar cilësinë e shërbimit, përmbushjen e pritjeve të konsumatorëve. Qëllimi i këtij kursi është për të diskutuar dhe për të analizuar disa tema të rëndësishme që lidhen me organizatat e shërbimit. Pas përfundimit të suksesshëm të këtij kursi, studentët do të fitojnë njohuri reth sfidave që përfshihen në marketingun e shërbimeve, që do të identifikojnë dallimet në mes shërbimeve të marketingut kundrejt marketingut në organizimin e prodhimit. Lënda do të mundësojë nxënësit të identifikojnë dhe analizojnë komponentët e ndryshëm të marketingut miks të shërbimeve.